



Pranuar / Dorezuar Prijemeno / Prelozilo Received / Delivered	20.04.2021	1	viti god year
Organ / Agjencia Org / Jedinica Org / Unit	In Proti Pr. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHIK	1903/2021		116



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.173/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.173/2021 të datës 23.03.2021 të parashtruar nga ankuesi [ ] të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Flakron Abdullahu me adresë Rr."Marije Shllaku" pn, në Gjilan, kundër organit të punësimit /Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.04.2021, mori këtë:

### V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.173/2021 e datës 23.03.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Gjilanit, që të zbatojë këtë vendim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë kompensimin e dy (2) pagave në vlerën e pagës së fundit të ankuesit, në emër të kompensimit të pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, dhe një (1) pagë jubilarë në vlerë të një page mujore, në emër të pagës jubilarë për përvojë punë, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi nëpërmjet përfaqësuesit të tij me autorizim Avokatit me datë 22.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1317/2021 të regjistruar me numër A.nr.173/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes në kërkesë të datës 22.02.2021, të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, me pretendimin ankimor për kompensimin e dy (2) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.03.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Gjilanit. Këshilli, me datë 07.04.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjilanit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin e dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 23.03.2021 me Nr. Prot:1317/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë e datës 22.02.2021 nga Kryetari i Komunës së Gjilanit për ankuesin; Kërkesën e datës 28.12.2020 nga ankuesi për Zyrën e Kryetarit të Komunës së Gjilanit; Aktvendimin C.nr.2111/20 të datës 04.12.2020 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil; Aktvendimin Ac.nr.2959/18 i datës 05.10.2020 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktgjykim C.nr.150/2017 i datës 12.02.2018 i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil; Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës i datës 10.01.2016; Vendimin e datës 30.06.2013; Vendimin për pagesat tjera në rrethana të veçanta i datës 18.01.2017; Lista e pagave për ankuesin; Autorizimi; E-maili i datës 22.03.2021; Akt Emërimit të datës 22.07.2021; Kërkesë për informata zyrtarë për Administratorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë; Përgjigjen e datës 12.04.2021 nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Përgjigjen në ankesë e datës 07.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pjesërisht bazuar, sepse:

Ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Gjilanit në bazë të Akt Emërimit të datës 22.07.2011 në pozitën "Koordinator i Zyrës Komunale për të Drejtat e Njeriut". Kryetar i Komunës së Gjilanit më datë 10.01.2016 ka nxjerr Vendim me Nr. 1034 për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit nga data 20.01.2017, ndërsa në bazë të Vendimit të datës 18.01.2017 ankuesit i është njohur e drejta e një page të njëhershme me rastin e pensionimit në vlerën 590 euro.

Ankuesi duke mos qenë i kënaqur me këtë, më datë 07.02.2017 ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Gjilan me pretendimin për pagesën e dy pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, më datë 12.02.2018 ka nxjerr Aktgjykim C.nr.150/2017 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesit duke e obliguar Komunën e Gjilanit të bëjë kompensimin e dy pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë. Komuna e Gjilanit ndaj këtij aktgjykimi ka parashtruar padi në Gjykatën e Apelit të Kosovës, e cila me Aktvendimin Ac.nr.2959/18 të datës 05.10.2020 ka aprovuar ankesën e Komunës së Gjilanit duke e prishur Aktgjykimin C.nr.150/2017 të datës 12.02.2018 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil dhe lëndën e kthen në rishqyrtim në gjykatë për procedim të serishëm. Gjykata Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil më datë 04.12.2020 ka nxjerr Aktvendim C.nr.2111/20 me të cilin është shpall jo kompetent për të vendosur në këtë çështje juridike civile, ndërsa pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, shkresat e kësaj lënde t'i dërgohen, Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Administrative si gjykatë me kompetencë lëndore.

Ankuesi pas Aktvendimit C.nr.2111/20 të Gjykatës Themelore në Gjilan, më datë 28.12.2020 ka parashtruar kërkesë të Zyra e Kryetarit të Komunës së Gjilanit për kompensimin e dy pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Kryetari i Komunës së Gjilanit më datë 22.02.2021 ankuesit i është përgjigjur në kërkesën e tij duke e njoftuar se jeni pensionuar në janar të vitit 2017 dhe keni lëshuar afatin ligjor për ankimim sipas nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas pranimit të ankesës, më datë 08.04.2021 ka kërkuar informatë nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë nëse është hapur rasti në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative sipas Aktvendimit C.nr.2111/20 të Gjykatës Themelore në Gjilan ndërsa Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë, më datë 12.04.2021 ka njoftuar se sipas të dhënave nga sistemi elektronik i menaxhimit të lëndëve SMIL, nuk evidentohet rast i hapur (lëndë) i regjistruar në emër të personit të lartcekur për çështjen e lartcekur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar provat e lëndës, konstaton se ankuesi kundër mos pagesës së dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë nuk ka filluar procesin e ankimit në procedurë administrative por brenda afatit ligjor nga koha e pensionimit ka filluar procesin gjyqësor në Gjykatën Themelore në Gjilan, si rrjedhojë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se ankuesi edhe pse nuk ka parashtruar ankesë në procedurë administrative, fillimi i procesit gjyqësor për të njëjtin objekt të lëndës, e bënë që procedura e filluar nga ankuesi është brenda afateve ligjore në fuqi sepse në Aktvendimin Ac.nr.2959/18 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, përveç tjerash theksohet që me nenin 81 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shërbyesit Civil të Kosovës,

përcaktohet se: "1. Organe qendrore të veçanta për zgjedhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë; 2. Procedurat për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe; 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës".

Bazuar në provat e lëndës dhe pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton ankuesi me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës si rezultat i arritjes së moshës së pensionimit ka përfitur një pagë sipas deponitave të nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, atëherë duke u bazuar edhe në praktikën vendimmarrëse të Gjykatës së Apelit të Kosovës, e cila në aktgjykimet për objektin e njëjtë të lëndës palëve u është njohur e drejta e kompensimit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, për këtë arsye Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka filluar të zbatohet për tri (3) vjet nga 01.01.2015 ku nënshkruese të saj në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka qenë Kryeministri i Kosovës, në këtë rast kjo marrëveshje për kohën sa ka qenë në fuqi ka qenë e zbatueshme edhe për nëpunësit e administratës shtetërore.

Sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive i punësuar, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt të fundit, siç përcaktohet me nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, i cili përcakton se: **"I punësuar, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt të fundit"**, mirëpo duke pasur parasysh se ankuesi ka përfitur një pagë me rastin e pensionimit, atëherë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesit i njihet e drejta e kompensimit edhe e dy (2) pagave të tjera në vlerën e pagës së fundit, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensim të tri (3) pagave jubilarë të përvojës së punës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke marr parasysh se Shërbimi Civil është krijuar me Rregulloren 2001/36 e cila ka hyrë në fuqi më datë 22 dhjetor 2001, vlerëson se përvoja e punës në shërbimin civil duhet të llogaritet nga viti 2001 dhe mbi bazë të kësaj edhe kompensimin jubilar mund të kompensohet vetëm nga viti 2001 kur është krijuar Shërbimi Civil.

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se, ankuesi nuk ka përvojën e punës në shërbimin civil për vitet e pretenduar pasi që nga koha kur është krijuar shërbimi civil deri në pensionim ankuesi nuk ka ma shumë se 17 vite përvojë të punës rrjedhimisht në bazë të kësaj nuk i takon kompensimi jubilar në vlerën e tri (3) pagave, po shpërblimi jubilar bëhet për çdo dhjetë (10) vite përvojë të punës pa ndërprerje,

kështu ankuesi në bazë të provave të lëndës përfiton vetëm një (1) pagë nga shpërblimi jubilar siç parashihet me dispozitat e nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ku përcaktohet se: *I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij*", bazuar në këtë pretendimi i ankuesit është pjesërisht i bazuar, rrjedhimisht Komuna e Gjilanit obligohet që në emër të shpërblimit jubilar ankuesit ti bëjë kompensimin e një (1) page në vlerën e pagës së tij të fundit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se nëse rasti i palës trajtohet nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, atëherë në kuptim të Ligjit për Konfliktet Administrative respektivisht dispozitave të nenit 36.1 *"Nëse organi gjatë kohës së procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të cilin revokohet ose shfuqizohet akti administrativ kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, si dhe në rastin nga neni 29 i këtij ligji nxjerr më vonë aktin administrativ, ky organ, përpos paditësit, do ta njoftojë edhe gjykatën. 2. Në këtë rast gjykata do ta ftojë paditësin që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të deklarojë nëse me aktin administrativ të nxjerrë në afatin e mëvonshëm: 2.1. është i kënaqur; 2.2. nuk heq dorë nga padia; 2.3. pjesërisht heq dorë nga padia; 2.4. ai/ajo padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër. 8 3. Nëse paditësi deklaron se me aktin e nxjerr në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk e jep deklaratën brenda afatit nga paragrafi 2. i këtij neni , gjykata do të nxjerrë vendimin mbi pezullimin e procedurës. 4. Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është ai/ajo i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën"*, ky vendim do të dërgohet edhe Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.173/2021

Avdyll BEKTESHI,



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.